

BIBLIOTEKA
SHTETIT

398.8
M47

MBLIDHUNI T'IA THEMI



39
N'42.

għalli u hekkixx ja kalkura

MBLIDHUNI T'IA THEMI

Këng ē popullorre tē zgħedhura
pēr fēmijē



39255

27-NOV-2018 - 10:00 a.m. (local time) - 1000 x 900 pixels

NOMINAZJON BOTUESE - NAIM FRASHERI

SHTEPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

93
14-347


Seria e poezisë së zgjedhur për fëmijë.

IMIHT ART KUHICILIM

studhix bëj esenqen qëndron
bënësi tëq

Tirazhi 3000 kopje Format 70 x 100/32 Stazh: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1978



I — KENGÈ HISTORIKE



NË ZEMËR I KEMI

Këngë për Partinë,
për xhaxhi Enverë,
do këndojm' me gaz
neve kurdoherë.

Në zemër i kemi,
me ta ne marshojmë,
me ta do të ecim,
kurrë s'do ndalojmë.

PARTI TRIME, MOJ LULE

Do këndoј si asnjeherë,
Parti trime, moj lule! (1)
Do këndoј për xaxhi Enverë.
Ne fatosat i premtojmë
se më shumë do të mësojmë,
veprën tënde do vazhdojmë.

1) Përsëritet pas çdo vargu.


KËNDOJMË PËR TY, XHAXHI ENVER

Ne jemi fatosa,
që në fest' na prunë,
se këngët e vendit
i pëlqejmë shumë.
Dhe nga Fushëbardha
zgjodhëm menjëherë
këngën më të dashur
për xhaxhin Enverë.
E kemi të bardhë
ne urimin tonë:
«Rroft' xhaxhi Enveri,
që na do gjithmonë;
që për ne fatosat
mendon me Partinë
dhe si lule mali
e bën Shqipërinë » (1)

1) Kënduar nga fatosat e Fushëbardhës (Gjirokastër) në festivalin folklorik, që u zhvillua në Gjirokastër (tetor 1968).



(1) Kündigung einer kleinen Fledermaus (Gitarre)
2. (2) Kündigung einer kleinen Fledermaus (Gitarre
3. (3) Kündigung einer kleinen Fledermaus (Gitarre)



JAM FATOS E DO KËNDÖJ

Jam fatos nga Labëria,
nga Rrëzoma, Fushvërria,
do këndoj: «Të rroj Partia!»
si këndon gjith' Shqipëria;
do këndoj e do hedh valle,
sa të tunden këto male.

Jam fatos e do këndoj,
librin fort do ta shtrëngoj;
kur të rritem edhe ca,
kazm' e pushkë do të mba;
do punoj e vigjëloj,
Shqipërinë ta lulëzoj. (1)

1) Kënduar në festivalin kombëtar folklorik të Gjirokastrës (1973) nga pionierë të rrëthit të Sarandës.



PUSHKËN E MBAJ MIRË NË KRAH

Pushkën e mbaj mirë në krah,
pse habitni tuj shikue, un sot s'jam i vogël,
xhaxhit Enver për t'i këndue, kceva mal e ko-
dër.

Me tirq të bardhë, qeleshe n'kokë, knoj kangt'
e malsisë,
kshtu na tha xhaxhi Enver në Plenum t'Parti-
së.

Asht e vogël çiftelia, t'madhes s'muj me i ra,
porse pushkën, xhaxhi Enver, e mbaj mirë në
krah!¹⁾

1) Kënduar në festivalin kombëtar folklorik të Gjirokastrës (1973) nga pionierë të rrethit të Kukësit.



3. diabolik-szövetségi üldözési és szabotági (E.
M.) törökországi hadművek (1781) alkalmából
1784

LIONELET DEDIKIMI SULMOJME ME TRIMËRI

Nga Jugu për në Vëri,
lule Çelo Sinani! (1)
Bëhej lufta me furi,
sulmoje me trimëri.
Atje në Shosh 2) e në Shalë 3),
shkoje përpëra në ballë,
Çelo, na mbete i vrarë!

1) Çelo Sinani, nga fshati Picar (Gjirokastër). Me-gjithëqë ishte i vogël, pionier, ai doli partizan dhe mori pjesë në luftime kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit. Në një natë nën-tori plot shi të vitit 1944, Çeloja ra dëshmor gjatë një përpjekjeje me armiqëtë në Dukagjin. Par-tia e nderoi në 25-vjetorin e Clirimt me titu-lin e lartë «Hero i Popullit».


2, 3) Krahina në rrëthim e Shkodrës.

PIONIERIT DËSHMOR MET HASA

Çdo pesë maj, lulet buqetë
i marr n'dorë, ngjitem përpjetë,
n'majë t'bjeshkës si kunorë,
ku Met Hasa (1) ra dëshmor.
Ndërpreu lojnat bregut t'detit,
se në zemër i vlonte Metit
gjak i ndezun për vatan,
tremdhetë vjeç duel partizan.
Nëpër male, nëpër curra (2)
lufton Meti përkrah me burra,
përkrah shokve partizanë,
hidhet para si luan.
Dhe at ditë në maje t'sukës, (3)
tuj liftue për çlirim t'Pukës,
i vu gjoksin mitralozit,
i thirri «Para!» batalionit.
Pa e lshue pushkën prej dore,
ra dëshmor brenda n'llogore;
n'male t'Pukës, një trim durrsak



tokën nanë njomi me gjak.
Shokve t'Metit u premtojmë
se ne kurrë s'do ta harrojmë.
Lapidari atje, në pyll,
ditë e natë ndriçon si yll! (4)



-
- 1) Dëshmori Met Hasa qe nga Durrësi. Megjithë-që në moshë fare të njomë, u hodh me guxim në radhët partizane, duke luftuar me trimëri të rra-llë për çlirimin e atdheut.
 - 2) Curr-i — shkëmb i lartë.
 - 3) Sukë-a — kodër.
 - 4) Kënduar në festivalin kombëtar folklorik të Gjirokastrës (1973) nga pionierë të rrethit të Pukës.

GJËMON SHKËMBI, TUNDET VENDI

Gjëmon shkëmbi, tundet vendi,
shkon rinia si ergjëndi,
si ergjëndi shkon rinia,
posi zjarr' e si shkëndia.
Dilni e shihni rininë,
nga rrug' e «Dritës» ⁽¹⁾ po vijnë,
«S»-të ⁽²⁾ e «L»-të ⁽³⁾ u vetëtijnë.

-
- 1) Rruga ku janë sot hidrocentralet «Karl Marks»
dhe «Frederik Engels».
2) S: Sulmues.
3) L: I lavdëruar.



NË KOOPERATIVËN TONE

Në kooperativën tonë
bereqeti det,
plot e plot hambarët,
mbushen vjet për vjet,

NË TË HYRË TË FIERIT

Në të hyr' të Fierit,
një fabrik' e re,
Shqipëri' e vogël,
bahçe me lule;
do prodhoj' shumë gjëra,
plehra kimike,
Shqipëri e vogël,
yll' i botës re.

ZIEN PUNA NË FABRIKË

O fabrik' e sodës, (¹)
sa e bukur je,
pranë detit, si kreshnilke,
ngrihe gjer në re.
Zien puna në fabrikë,
dit' e nat' prodhojmë,
sod' të markave shqiptare,
në bot' na nderojnë.
Në Evrop', Afrik', Azi,
botës anembanë,
soda jonë po çan dete
edhe oqeanë.

1) Fabrika e sodës kaustike në Vlorë.

NËRT NGA DURAGJINI S'TË DËRRMOI PO E DËRRMOVE

Xpjet e Dërrmove
Në nëntor të atij viti,
Lule Adem ⁽¹⁾ komunisti, ⁽²⁾
hape krahët si petriti,
sipër valës ti qëndrove,
s'të dërrmoi, po e dërrmove.

- 1) Komunisti Adem Reka, që ra heroikisht në
krye të detyrës më 17 nentor 1966 për shpëti-
min e bigës.
2) Përsëritet pas çdo vërgu.

ZBRET NGA DUKAGJINI

Zbret nga Dukagjini
për në Myzëqe,
Shkurte Pal Vata, (¹)
komunist' e re.
Fjalën e Partisë
ti e dëgjove,
me shok' edhe shoqe
ti u bashkove
dhe në hekurudhë
vullnetare shkove.
Re si heroinë
për jetën e re,
emri yt i shtrenjtë
lapidar për ne.

1) Vajza 15-vjeçare nga Pecaj i Dukagjinit, që
ra trimërisht duke punuar si vullnetare në he-
kurudhën Rrogozhinë-Fier (nëntor 1967). Me ven-
dim të posaçëm të KQ të PPSH u pranua si ko-
muniste pas vdekjes.

~~HISTORIKI~~

FJALA HISTORIKE

Fjala historike (1)
e shokut Enver
do të jet' për ne
busull kurdoherë.
Të ecim përpara
me Partin' krenarë,
të qëndrojm' gjithmonë
si revolucionarë.

1) Fjalimi i shokut Enver më 6 shkurt 1967.

MBLIDHUNI T'IA THEMI

MEMORIAL HISTORY

Mblidhuni t'ia themi (')
këngës, more shokë,
Xhaxhin pran' e kemi,
të gëzojmë tok,
Xhaxhi yn' Enver
afër midis nesh,
sot, si asnijëherë,
buza sa i qesh.
Foli me të tërë,
me pleq të moshuar
dhe me pionierë,
ç'i ka përqafuar!
Ne të gjith' e rrokëm,
zemra na buçiti,
lule Enver Hoxha,
Gjirokastrën ndriti.

1) Kënduar nga nxënësit e grupit lab të shkolles «29 Nëntori» Gjirokastër, me rastin e vizitës që bëri shoku Enver Hoxha në këtë qytet, në maj 1969.

ZEMRA NA KENDON

Sistë vegjël që ne jemi,
zemra na këndon
për Partin', xhaxhin Enver
që kujdes tregojnë.
Brez' i ri i Shqipërisë
neve jemi sot,
lidhur si mishi me koskën,
kush s'na ndan dot.
Do mësojmë, do punojmë
më shumë nga sot,
lavdi ty, Parti e Punës,
lavdi jet' e mot!

PIONIERË EMNIN E KEMI

Gzon Mirdita e gzon Shqipnia
për kët brez që rrit Partia.
Shkolla e shpia plot me dritë,
fmijë të lumtun janë tu u rritë.
Pionierë emnin e kemi,
bij' t'Enverit t'gjithë, na jemi!
Sikur ju, mor moshatarë,
shkoj në shkollë dhe un krenar.
Due si librin, gjimnastikën,
t'jem' i fortë për Republikën.
Në mes t'puntorve edhe bujqve,
mbaj në qafë shamin' e kuqe!
Kjo shami, që mbaj rreth gushës,
na tregon kohën e luftës;
kur i rrinte partizanit
si flamur sipër gjerdanit.
Për pionierët e vendit tonë
si flamur do t'jetë gjithmonë!

Jam i vogël, moj çifteli,
telat mirë t'i dridh s'i di,
por i premtoj xhaxhit Enver
si malsor i si pionier:
Kurdoherë ushtar un jam,
me grusht lart si partizan!

Neve jam i pionierë
pij is Spidjetis se te
nën kujdesin e Partizanë
un shpërbllojë mësojëtë
tutje që përfundoi te është
zgjedhur tiflani per shtëpi
Nevejam pashqitësja e
nëtijës së dërgojë ne
Ne bëqështë at që do të
zgjedhur që nuk e
Ku qëndrueshëm po që
at që do është

Neve jemi pionierë,
brijtë Shqipërisë së re,
nën kujdesin e Partisë,
në shkolla mësojmë ne,
që të bëhemë të ditur
edhe trima për atdhe.
Nesër Partia stafetën
do na dorëzojë ne.
Ne përpara do ta çojmë
si na mson xhaxhi Enver.
Ky është betimi jonë,
që do ta mbajmë me nder.

NEVE JEMI PIONIERE

II — KENGÈ LIRIKE

NA KËTË LULE

— Na këtë lule!

— Ç'është kjo lule?

— Lule e miut,

miu që hëngri qenglën (¹)

e samarit të gomarit.

— Na këtë lule!

— Ç'është kjo lule?

— Lule e macesë;

macja që hëngri minë,

miu që hëngri qenglën

e samarit të gomarit.

— Na këtë lule!

— Ç'është kjo lule?

— Lule e qenit;

1) Rrip prej leshi të dhisë, që shkon nga shala a
samari për nën bark të kafshës; nën barkëse.

qeni që hëngri macen,
macja që hëngri minë,
miu që hëngri qenglën
e samarit të gomarit.

— Na këtë lule!

— Ç'është kjo lule?


— Lule e kapllanit;
kapllani që hëngri qenë,
qeni që hëngri macen,
macja që hëngri minë,
miu që hëngri qenglën,
e samarit të gomarit. (2)

2) Radhiten fëmijët në formë rrëthi; njëri prej tyre merr në dorë një lule dhe ia jep shokut që ka në krah, duke i thënë: — Na këtë lule. Fëmija që ka marrë lulen, pyet: — Ç'është kjo lule? Dhe ia dorëzon lulen shokut, që vjen pas tij, i cili përsërit të gjitha fjalët, që vijnë më poshtë (lule e...). Po qe se njëri gabon, del nga loja. Loja vazhdon derisa të gabojnë të gjithë pjesëtarët e saj. Ai që ngel i fundit pa gabuar del fitues.



NA KËT QIRI

— Na kët qiri!
— Ç'asht ky qiri?
— Qiri mbi qiri,
fitil mbi fitil,
fitilin e hëngri miu.
Miun e hëngri macja,
macja kceu mbi tra,
trarit iu dha zjarri,
zjarrin e shoi uji,
ujin e pinë buajt,
buajt punuan arën;
na i qitën farën,
farën e hëngri zogu,
zogu hini në ferrë,
ferrën e preu kmesa,
kmesa shkoi te kovaçi... .



Ç'U BË MISHTË

- Ç'u bë mishtë?
- E hëngri macja.
- Macja ç'u bë?

- Hipi në lis.
- Lisi ç'u bë?
- E preu sëpata,
- Sëpata ç'u bë?
- E theu guri.
- Guri ç'u bë?
- E mori lumi.
- Lumi ç'u bë?
- E pinë qetë.
- Qetë ç'u bënë?
- I hëngri ujku.
- Ujku ç'u bë?
- E vrou dyfeku.

SEÇ MË DHA NJË CAPK' BABAI

Seç më dha një capk' babai!
Shoqeni dhe moj!
Capkën seç ma hëngri ujku!
Ujk-o, more ujk,
që më hëngre capkën,
capkën, more, capkën,
që më dha babai,
shoqeni dhe moj!
Ujkun seç ma fshehu ferra!
Ferrë, moj ferrë,
që ma fshehe ujkun,
që më hëngri capkën,
capkën, more, capkën,
që më dha babai
shoqeni dhe moj!
Ferrën seç ma dogji zjarri!
Zjarr, more zjarr,
që më dogje ferrën,

që, ma fshehu ujkun
që më hëngri capkën,
capkën, more, capkën,
që më dha babai,
shoqeni dhe moj.

Zjarrin seç ma shojti lumi!

Lum, more lum,
që më shojte zjarrin,
që më dogji ferrën,
që më fshehu ujkun,
që më hëngri capkën,
capkën, more, capkën,
që më dha babai,
shoqeni dhe moj!

LART EDHE MË LART

Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një pulë,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;¹⁾
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.
Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një rosë,
rosa bënte «ros, ros, ros»,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.
Lart edhe më lart,

1) Lakror a petanik.

dola në pazart,
në pazar bleva një patë,
pata bënte «pat, pat, pat»;
rosa bënte «ros, ros, ros»;
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.

Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një miskë,
miska bënte «mis, mis, mis»;
pata bënte «pat, pat, pat»;
rosa bënte «ros, ros, ros»;
pula bënte koqevenë
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.

Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një dhi,
dhia thoshte «milmë mua»;
miska bënte «mis, mis, mis»;
pata bënte «pat, pat, pat»;
rosa bënte ros, ros; ros;»;
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;

gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte,
Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një dele,
delja thoshte «qethmë mua»,
dhia thoshte «milmë mua»,
miska bënte «mis, mis, mis»,
pata bënte «pat, pat, pat»;
rosa bënte «ros, ros, ros»,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.
Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një dem,
demi thoshte «msomë mua»,
delja thoshte «qethmë mua»,
dhia thoshte «milmë mua»,
miska bënte «mis, mis, mis»,
pata bënte «pat, pat, pat»;
rosa bënte «ros, ros, ros»,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.

Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një ka,
kau thoshte «zémë mua»,
demi thoshte «msomë mua»,
delja thoshte «qethmë mua»,
dhia thoshte «milmë mua»,
miska bënte «mis, mis, mis»,
pata bënte «pat, pat, pat»,
rosa bënte «ros, ros, ros»,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.

Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një mushkë,
mushka thoshte «ngarkomë mua»,
kau thoshte «mibrîhmë mua»,
demi thoshte «msomë mua»,
delja thoshte «qethmë mua»,
dhia thoshte «milmë mua»,
miska bënte «mis, mis, mis»,
pata bënte «pat, pat, pat»
rosa bënte «ros ros, ros»,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,

tra më tra ia thoshte.
Lart edhe më lart,
dola në pazart,
në pazar bleva një kalë,
kali thoshte «hipmë mua»,
mushka thoshte «ngarkomë mua»,
kau thoshte «mbrimë mua»,
demi thoshte «msomë mua»,
delja thoshte «qethmë mua»,
dhia thoshte «milmë mua»,
miska bënte «mis, mis, mis»,
pata bënte «pat, pat, pat»
rosa bënte «ros, ros, ros»,
pula bënte koqevenë,
cuca tëhollte gjyslemenë;
gjeli po këndonte,
tra më tra ia thoshte.

KUR LUAJNË GURMACASH


Vjen miu «pic»,
vjen macja «gërric»,
vjen topuzi «bam»,
vjen qeni «ham»,
vjen sëpata «pret»,
vjen këlliçi «hek», (¹)

1) Këto vargje thuhen prej fëmijëve kur lozin «gurmacat» (Gurmac-i, gur i vogël i rrumbullakët, me të cilin lozin kalamajtë). Njëri prej tyre hedh e pret një gurmac, duke marrë në të njëjtën kohë njërin prej të 6 gurëve, që janë vendosur në shesh. Kur i merr që të gjithë gurët, thuhet se «ka bërë një mace». Fiton ai që ka bërë shumë «mace».

GU, GU, PICI GU

Gu, gu, pici gu,
Kam një kalë pa shalu,
sa vjet, sa net,
sa gishta kam përpjetë ¹⁾)

1) Fëmijët radhiten në formë gjysmëharku. Njëri prej tyre vendoset përballë shokëve dhe thotë këto fjalë, duke ngritur duart lart me sa gishtérinj që ai dëshiron. Fëmijët e tjerë janë të detyruar të thonë sa gishta ka përpjetë shoku i tyre; kush e gjen, merr drejtimin e lojës. Ai që gabon, del nga loja dhe pret sa të fillojë loja nga fillimi.



UNË JAM LJEPUR

- Gëzuashi!
- Mir' se erdhe
- Po cili je ti?
- Oj, q'jam unë!

Nukë më di?

- Besa s'të di!
- Po si s'më njeh?
- Besa që jo!
- Po un jam ljepur,
- Qysh je ljepur?
- Besa ljepur,
- Veshët ku i ke?
- Po nuk m'i sheh?
- Jo, s't'i shoh!
- Qysh s'm'i sheh?
- Besa që jo!
- Po ja një, edhe një. (^)

NUKË MË DI

1) Fëmijët radhitin 34 kokrra fasule, misër, ose qiqra në dy shtylla paralele dhe, duke i hequr ato dy e nga dy, përsërisin këto fjalë. Në fund mbeten dy kokrra, ato janë «veshët e ljepurit».

HAPA, DOLLAPA

Hapa, dollapa,
kush  sht  prapa,
se m  zuri vapa,
vapa e korrikut
n  hije t  fikut.
Huj e pthuj!¹⁾)

1) K to varje thuhen prej f mij ve, kur lozin «symbyllazi». Ato i thot  ai q   sht  caktuar p r t  mbyllur syt .

KUKULLE, MOJ KUKULLE

Kukullë, moj ^{aqsh} kukullë,
e bardhë, e bukurë, ^{daz} dani
e bardhë si bora, ^{mus} ëm o
e kuqe si molla, ^{korri} e vezur
e kuqe si shegë, ^{qit} si stid ^{qit}
kukull me lezet. ^{jufiq} e ^{qit}

HOVI I MADH

Hovi i madh, hov i vogël, tue shëtitë
hovi i vogël, hov i vogël, tue shëtitë
nëpër Shkodër: nëpër Shkodër:
nën kumbull, nën kumbull, nën kumbull
nën mand, nën mand, nën mand
hopaaa, hopaaa! (1) hopaaa, hopaaa! (1)

1) Këndohej në Shkodër duke u lëkundur në shtregull.

UNE SHENDET AM I IVOH

Han' e re, ibgan i ivoh
vash' e re, lögov i ivoh
ti shëndetin, ëtëndës eut
unë gërshetin, ëbokës qëdës
Hanë, hanë, llugmuri i ëm
hanë e re, brasim nëd
ti e re, (') lësagod, nraqod
unë e re,
ti si rrëth,
unë shëndet,
ti si shkop,
unë si top! (')

1) Këndohet prej fëmijëve, kur del hëna e re në
fillim të pranverës.

HAN' E RE

Han' e re,
lum pér ne;
ti tuj shndritë;
un tuj u rritë! (¹)

1) Shiko shenimin e kenges se meparshme.

HÈNEZ-O, HÈNEZ-O МАН

- Hënëz-o, hënëz-o,
mos më pe babën-o?
- E pashë në fushë,
e putha në gushë;
e pashë në arë,
e putha në ballë.

HËNËZË, SA DIT' KE ZËNË

Hënëzë, sa dit' ke zënë,
që ke veshurë takëmnë,
në qafë zinxhir t'ergjendë,
të ergjendë e të floritë,
sa bukur m'i ke sytë,
ata syt' e bukur-o,
ku je, që s'je dukur-o?!
Hën, e bukur rrumbullake,
kush t'i puthi ato faqe,
ato faqe si tabake?
O moj hënëz kanakare,
që vështron kodra dhe male,
mos më pe vëllanë ti,
që rri roje në kufi,
nëpër borë e nëpër shi,
mbron atdhenë me trimëri?
Un' flë gjumë në shtëpi,
shkoj në shkollë dhe mësoj,
detyrat i plotësoj!

О МОЈ БОРЁ, БОР' Е РЕ

O moj borë, bor' e re,
mirë se na erdhe,
që shkele këtu përdhe,
edhe vendin e zbardhe;
ti e ftoht' e un e ngrohtë. (1)

1) Kjo këngë këndohet nga fëmijët, kur bie bora
herën e parë.



BORË, BORË, FLOKË-FLOKE

Borë, borë, flokë-flokë,
që na bie përmbi kokë,
ne do të qeshim,
pastaj do të ngjeshim;
se me ty, pak nga pak,
do të bëjmë një kulak;
lakut, kulakut,
mendjedhelpérakut,
do t'i vëmë një gojë,
që të urdhérojë,
dhe një bark si furrë,
që mos ngopet kurrë,
dhe një shkop në duar
për të kërcënuar!
Ua, po ky diell që leu,
gjithë rrezet ia mbértheu,
dhe kulaku turimi
pak nga pak shkriu.
Posi ty pak nga pak
do të shkrihet çdo kulak!



RE, RE, BOBO RE

Re, re, bobo re,
lësho diellin përmbi dhe,
të ngrohem i ne të tre,
ne të tre të mirëtë,
buzëkarafilëtë!

SHI, SHI, LAGA SHI

Shi, shi, laga shi,
lagu ty, lag mua,
lagu faqet e Skënderit,
porsi topaf e sheqerit.

(I)

is deni bozoxbey

RE, RE, KOKO RE

Re, re, koko re,
lëshona diellin përdhe,
se të lëshoj shpatën,
shpatën e gomarin,
si dhia përallin,
si keci lastarin,
si delja barin,
si kulishi reckën,
si gomari bexgën, (1)
si qeni povexgën.

1) Bezgë, sfakë, sherebelë — shkurre me lule të verdha.

KORTOSHEED TYM, TYM

Tym, tym,
koko tym,
as andej,
as këndej,
po përpjetë
si shigjetë. (¹)

1) **I** thonë fëmijët, kur ndezin zjarrin dhe tymi
iu mbyt sytë.

KOLLOZHEGU DJEGËSHTEGU

Kollozhegu (¹) djegështegu.
Shkurti shkurton urëtë,
marsi mbledh lëkurëtë,
prilli këndon bilbili,
maji koko maji,
qershori qershit' na solli,
korriku vjen rrotull shiniku.

1) Kollozhegu: janari.



JU, LULE, GJITHË SA JINI

Ju, lule, gjithë sa jini,
të parën lule kë kini?
Të parën ne kemi kaçen
të dytën manushaqen.
Manushaqe, me shëndet,
prite borën sa u tret,
pastaj dole përmbi dhetë.

SIPËR E ME SHËNDET

Shëndet e më shëndet
dëshmorët e sëmundjeve
dëshmorët e sëmundjeve
dëshmorët e sëmundjeve



SIPĒR E MË SIPĒR-E

Sipēr e më sipēr-e,
dalim mu në majë tē malit-e.
Mu në shesh tē luleve,

vijn' e na këpusin-e,
tufa-tufa na ujdisin-e,
po në krye na vinin-e,
po në brez na shtinin-e...

NE AVLESNI PËR MAMUSHVË

Ne avlesni per mamsupas
mettumeni qje mur
Ps ne mos diea t'i mpedehi
mësosmëni qje mur
Ne mos diea t'i pël turs
mësosmëni qje mur
Tufs-tufs mamsupas der
t'i leshnë me tider (1)

1) Këndohet prej fëmijëve në fillim të pranverës, kur dalin për të mbledhur lule, me të cilat ata thurin kurora dhë i vendosin në kokë.

aljë, e us këpusin-e
tjuk-tjuk us njësia-e
bo tje këtë us avinë-e
bo tje pjes us shqipinë-e

NË VAFSHI PËR MANUSHAQE

Në vafshi për manushaqe,
merrmëni dhe mua.
Pa në mos diça t'i mbledh,
mësomëni dhe mua.
Në mos diça t'i bëj tufë,
mësomëni dhe mua.
Tufa-tufa manushaqet,
t'i rënditimë mbi faqet. ⁽¹⁾

1) Shiko shënimet e këngës së mëparshme.

ROZA E ROZINA

Roza, Rozina,
bjer ca dranafila,
bashkë me zamake,
edhe lule tjera,
se na doli vera.

Sjellu, sjellu rrumbullak
me nji tubë lule,
kush i do këto lule?

PAPARUNA FLETË-FLETË

Paparuna fletë-fletë,
m'e bukura nga shoqetë,
m'i ke të zeza perçetë
edhe fletëzat të kuqe,
mu në mes ke një burbuqe.
Paparuna anës lumit,
mbin dhe në majë të shkëmbit!

PILI, PILI, PIZGËZA

Pili, pili, pizgëza,
ndo del, ndo mos del.
Në mos del ti me hir,
do të dalësh me pahir.
O bilbil, o karafil,
në mos me hir, me pahir;
sa të piqet një vezë;
veza u poq,
bilbili u hoq! (¹)

1) Këto vargje, si dhe ato të dy këngëve që vijnë më poshtë, thuhen prej fëmijëve kur ata pregatishin bilbila në pranverë prej drurit të lofatës, fikut, frashërit ose të ndonjë druri tjeter.

DIL, BILBIL

Dil, bilbil,
karafıl,
sa tē dalç,
tē pēllcaç,
tē hash vezë
me kulaç.

(*)

DIL, CAMUNZA

Dil, camunza, kokërr ve,
sa të piqetë një ve,
veja u poq,
camunza u hoq.

TAKO TAKO

Tako, tako
bilbilako,
dil bilbil,
karafil,
se tē pres
mu nē mes,
Veza u poq,
bilbili u hoq!

CAN CAN, BILBILAN

Can, can, bilbilan,
pizga del, bilbili s'del,
do të hedh në ferrat,
të të hanë grerat;
can, can, bilbilan,
pizga del, bilbili s'del,
do të hedh në pust
të të rrah me topust;
can, can, bilbilan,
pizga del, bilbili s'del,
do të dalç me domosdo,
se unë të hedh në hambart
e të futem me sqepart.
Hu! Kërc, värc.

Doli!

ZHIU ZHIU IA BËN BLETA

Zhiu, zhiu ia bën bleta
nëpér gjethe, nëpér fleta,
në kullotë ajo del,
e ngarkuar me sheqer!

ÇIKË ÇIKËLORIJA

Çikë çikëlorija,
Mustafa tangorija,
me një copë djathë,
me tre kokorrathë.
Cingare, cingare,
ulu posht' e mos u ngre!
E kapa! (')

1) Kjo këngë këndohet prej fëmijëve në fillim të pranverës, kur fillojnë të dalin xixëllonjat e para, dhe ata turren t'i kapin.

REZE REZE BUKUREZE

Reze, (¹⁾ reze, bukureze,
shiko prapa, se u ndeze,
me kandil, me fitil,
me vajguri, me vaj t'mirë.

1) Xixëllojë.

Edhe këto vargje thuhen duke ndjekur xixë-llojat.

XHI XHI BUKURI

Xhi, xhi, bukuri,
a don venë, a don raki?
Pasha NN s'mund ta pi.
Kur të vij NN n'shpi,
hajm' e pijm-e,
rrahim lodërtin-e;
lodërtija bum-bum,
xhixhilloja në katund.
Gjith katundi po ban be:
xhixhilloja s'asht me ne.

SHKËNDI, SHKËNDI

Shkëndi, shkëndi, (1) eja më këteja,
të të jap një mollë,
të të mbaj në dorë.

1) Xixëllojë.

FLUTUR, FLUTUR

Flutur, flutur,
zonj' e bukur,
krahëshkruar,
pse nxituar?
— Jemi shokë,
të shkojm' tok!

FLUTUR, FLUTUR

Flutur, flutur,
babare,
merru mendsh
e bjer përdhe! . . . (1)

1) Këndohet prej fëmijëve kur kapin flutura në pranverë.

FLUTUR, FLUTUR

Flutur, flutur,
zoj' e bukur,
babare,
bjer përdhe.
Thot' bilbili,
trandafili:
Ç'ke me mu,
ç'je zemru?

DALLËNDYSHE FAQEKUQE

Dallëndyshe
faqekuqe,
sqepgjilpërë,
bishtgérshërë... (1)

1) Këndohet prej fëmijëve kur vijnë dallëndyshet buzë pranverës.

**QYQE, QYQE, E PARA
QYQE**


Qyqe, qyqe, e para qyqe,
pash mu, pash ty,
pash vllan' me njan sy,
sa vjet kam me rru,
qaq ke me m'diftu.
N'mos m'diftojsh,
u qërrofsh!

ZOG, ZOG LARAMAN

Zog, zog laraman,
a ma hudh nji kokërr man?
Zog, zog lara-lara,
m'hudh nji kokërr man përpara.

O LELEK, O LELEK

O lelek, këmbëdyfek,
ç'kérkove aty përpjetë,
eja posht' këtu tek ne,
thuaj një këngë të re:
— Beharin a e prure,
të gëzojmë edhe ne!?



O LEJLEK

O lejlek
këmbëdyfek,
hipe në çati,
na bëre shtëpi,
shtëpi me flutura,
xhiko nuse bukura.

KANGA E LEJLEKUT

O lejlek,
haxhibek,
thuej s'at'amë
e tyt et
të më presi
nji jelek;
të ma presi
me gérshanë,
të ma qepi
me gjylpanë,
e të rrijë
dede në kamë. (1)

1) Kur vijnë lejlekët e parë në fillim të pranverës dhe nisin të bëjnë çerdhet e tyre, fëmijët këndojnë këtë këngë.

KAURRILA

Kaurrila,
kaupata,
tri pllämë,
qafëgjata.
M'ka thanë nana,
m'ka thanë tata,
sillu rrotull,
bjer përdhe...
Si rrotulla n'bosht,
si mullini nën kosh. (1)

1) Në fillim të pranverës, kur vijnë në tufa kurrilat, fëmijët thonë këto vargje duke imituar cicerimin e tyre. Kurrilat, kur dëgjojnë zërat e fëmijëve që i imitojnë, ndodh nganjëherë, duke kujtar se janë shoqe të tyre, ulen në tokë.

HYRI MARSI, ERDHI PRANVERA

Hyri marsi, erdh pranvera,
ci - ci - ci zoqt' nëpër ferra,
manushaqe dhe burbuqe,
vetullzezë e faqekuqe,
ju jini lulet e para,
dhe zymbylja faqebardha.
Sot bujku del në ara,
që të bëjmë bukë plot,
elb e grurë e kallamboq,
plot fasule dhe patate,
plot baçeja me domate.



DUMBA, MOJ, DUMBA

Dumba, moj, dumba
zura dy pullumba;
njérin e kam

ta vë në tavan;
po tjetri më shkoi,
moj, më fluturoi,
vallë, ku qëndroi?
Vallë, kush e zuri?
Djalë zemërguri.

LARASKA LARAMANE

Laraska laramane
shkoi e ra n'ato stane.
Prite, moj çobane,
at laraskën laramane,
mos të prishi ato stane.

LAKURIQI NATËN

Lakuriqi natën
na e hëngri patën;
lakuriqi ditën
na e hëngri piten.

BUFI MARTOI TË VËLLANË

Bifi marnoi të vëllanë,
edhe thirri gjithë fshanë.
Kukumjaçka iu zemrua:
— Pse s'më ftove edhe mua?
Do të vija me peshqesh,
me një mace gjithë lesh.

PULË, PULË ME KAÇOTË

Pulë, pulë me kaçotë, (¹)
mos dil natën me kullotë,
se t'xe terri, (²)
t'ha bubazheli. (³)

1) Kaçullëz, kaçulitë.

2) Nata.

3) Përbindsh, me të cilin frikësöheshin kalamajtë.

TI, MOJ DHELPËR

Ti, moj dhelpër,
bishtkurorë,
ik andej
nga kjo Poshnjë; (¹)
shko matanë,
se atje janë,
zoqt' si moshnjë. (²)

1) Fshat i Beratit.
2) Të majmë.

CIMI, CIMI LJEPURI

Cimi, cimi ljepuri,
lakrori papjekuri,
miu e gatuante,
macja rri e ruante.

BRINCA KAÇORR

Brinca (¹) kaçorr,
kce e bje n'oborr.
Ç'kanë njerzit me mu?
Unë gja s'ju du.
Shpi kam shpellën,
shtrat kam ferrën.

1) Dërrasa të anëve të djepit.

TRI SPATA LATA-LATA

Tri spata lata-lata,
pren' tre plepa të gjata.
Plep' i gjat' i plasurë,
pak palc' paske pasurë! (¹)

1) Vargjet e kësaj këngë dhe të dy këngëve të tjera, që vijnë më poshtë, përpinquni t'i thoni disa herë me radhë shpejt.

TRI SOPATA PLAKA

Tri sopata plaka
presin tre plepa pleq.

GRUR-O GRUMBULL-O

Grur-o, grumbull-o,
grumbulli në lëmë tënë,
ç'i rri turtulli në këmbë,
turtull ballërruar-o,
lepur ballërjepur-o,
merr një gur e qëllo rraptë,
rrapi Risilisë,
në mes të avllisë.

POLLI LOPA LARE

Polli lopa larë
në lin' e rrallë;
e rralloi lop' e larë
lin' e rrallë.

Bellina ët ezmë ëz

Bellina ët ezmë ëz


Bellina ët ezmë ëz

KECI IM LARAGAN

Keci im laragan
shum' i bukur me nishan,
kömbëholl' e kërcigjatë,
zgjohet herët që me natë,
më më më nëpër oborr,
mua nga gjumi më zgjon;
hopri, hopri nëpër vathë,
cing, cing, cang zilja në qafë.
Keci im është manar,
i jap gjethe, i jap bar,
nëpër sheshe, në livadh!

О И ЗОТИ ДХИСЕ ШЫТЕ

О и зоти дхисе шыте
ларë, çалë nd'арë, merre дхинë шыте
ларë, çалë nd'арë, се rrаллои lin' e rrallë.



O MOJ PELEZA MËSHALE

O moj pelëza mëshale,
pel' e kuqe me karkale,
pela ime bishtbardhë,
si kërcen, si hidhe valle,

vare lelet' përmbi ballë,
edhe rruazat me radhë,
të qëndisurë me arë,
me gurë margaritarë.
Pel' e kuqe kadife,
shkon në mes të shoqeve,
posi plumb, posi rrufe.
—Pela ime, sa të dua,
se dhe ti më do mua;
u do flë, po dhe ti fli.
që të rritemi të dy!



O MOLLA ASKETILOM

O mol bëjëss mësirës
bëj, e këndë nra bëjëss
bës, iuc pëpësuarës
i përgjicës ia përditës

E HËNA I ÇON FJALE SË MARTËS

E hëna i çon fjalë së martës,
që t'i thojë së mërkurës,
vall' e ka dëgjuar e ejtja
të premten,
Kur i ka thënë së shtunës
se të dielën është pushim?

PRIMAM PASQYRA E LËNDËS

I. Këngë historike

— Në zemër i kemi	5
— Parti trime moj lule	6
— Këndojojmë pér ty, xhaxhi Enver	7
— Jam fatos e do këndojoj	9
— Pushkën e mbaj mirë në krah	11
— Sulmojmë me trimëri	13
— Pionierit dëshmor Met Hasa	14
— Gjëmon shkëmbi, tundet vendi	17
— Në kooperativën tonë	18
— Në të hyrë të Fierit	19
— Zien puna në fabrikë	20
— S'të dërmoi po e dërmovë	21
— Zbret nga Dukagjini	22
— Fjala historike	23
— Mblidhuni t'ia themi	24
— Zemra na këndon	25
— Pionierë emrin e kemi	26
— Neve jemi pionierë	28

II. Këngë lirike

— Na këto lule	31
— Na këtë qiri	33
— Ç'u bë mishtë?	34

— Seç më dha një capk babai	36
— Lart edhe më lart	38
— Kur luajmë gurmacash	43
— Gu, gu, pici gu	44
— Unë jam ljepur	45
— Hapa dollapa	47
— Kukullë moj kukullë	48
— Hovi i madh	49
— Unë shëndet	50
— Han' e re	51
— Hënëz o, hënëz-o	52
— Hënëzë, sa dit' ke zënë!	53
— O moj borë, bor'e re	54
— Borë, borë, flokë-flokë	55
— Re, re, bobo re	56
— Shi, shi, laga shi	57
— Re, re, koko-re	58
— Tym, tym	59
— Kollozhegu, djegështegu	60
— Ju lule gjithë sa jini	61
— Sipër e më sipër	62
— Në vafshi për manushaqe	64
— Roza e Rozina	65
— Parapuna fletë-fletë	66
— Pili, pili, pizgëza	68
— Dil bilbil	69
— Dil camunza	70
— Tako, tako	71
— Cau, cau, billbilau	72
— Zhiu, zhiu na bën bleta	73
— Çikë çikëloria	74
— Reze reze bukreze	75
— Xhi xhi bukuri	76
— Shkëndi, shkëndi	77
— Flutur, flutur	77

— Flutur flutur	78
— Flutur, flutur	79
— Dallëndyshe faqekupe	80
— Qyqe, qyqe, e para qyqe	81
— Zog laramani	82
— O lejlek, o lejlek	83
— O lejlek	84
— Kanga e lejlekut	85
— Kaurila	86
— Hyri marsi, erdhi pranvera	87
— Dumbe moj dumbe	88
— Laraska laramane	90
— Lakuriqi i natës	91
— Buçi martoi të vëllanë	92
— Pulë, pulë moj kaçotë	93
— Ti moj dhelpër	94
— Cimi cimi ljepuri	95
— Binca, binca kaçorr	96
— Tri sëpata lata lata	97
— Tri sëpata plaka	98
— Grumbullo, grumbullo	99
— Polli lopa larë	100
— Keci im laragan	101
— O i zoti i dhisë shyte	102
— O moj pelëza meshalë	103
— E hëna i çon fjalë së martës	105